


# KONTRIBUTI I AKADEMIK ESHREF ADEMAJ PËR TË DREJTAT KOMBËTARE DHE NJERËZORE TË SHQIPTARËVE



~ *Skënder Susuri* ~



Akademik Eshref Ademaj (1940-1994) me punën e tij të palodhur shumë produktive dhe shkencore, me mendjen e tij prodhuese e origjinale të shkencëtarit la vulën e vet për këtë kohë jo vetëm në rrafshin kombëtar por edhe në përmasa botërore. Me kontributin dhe aktivitetin e tij të guximshëm, të një vizionari dhe organizatori të shkëlqyer në organizimin e aktiviteteve dhe

veprimtarive të ndryshme në mbrojtje të autonomisë së shkollës shqipe, të autonomisë së Universitetit të Prishtinës dhe të zgjidhjes së drejtë dhe meritore të statusit të Kosovës, duke u ndodhur në ballë të protestave dhe demonstratave gjithëpopullore në vitin 1990 e në vijim, hyri në historinë kombëtare shqiptare si një nga veprimtarët më të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të viteve 90 të shekullit XX-të.

"Me temperamentin e tij të zjarrtë, i bëri herët idealet e veta aspiratat e bashkëkombësve për liri, të drejta kombëtare e njerëzore dhe përparim shoqëror. Ai ishte i ndërgjegjshëm se kjo luftë e vështirë do të zhvillohej në kushte inferioriteti në qoftë se shqiptarët nuk do të kishin njerezë të ditur, të aftë e me formim bashkëkohor që t'i orientonin në labirintet e ngatërruara në të cilat do t'a futnin luftën armiqët dinakë." "Akademik Eshref Ademaj jetoi me Universitetin e Prishtinës, u ngrit me të dhe e ngriti atë. Terë potencialin e vet intelektual e vuri në shërbim të Universitetit, që në vitet e para të krijimit të Universitetit, veprimtaria e tij e nxori në ballë të trupës pedagogjike e shkencore të këtij institucioni, që për jetën e Kosovës kishte tjetër rrezatim e ndikim, tjetër peshë po ta krahasosh me institucionet analoge të vendeve tjera."

Duke e ditur dhe vlerësuar Universitetin e Prishtinës si institucionin më të rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor në Kosovë, për popullin shqiptar, Akademik Ademaj asnjë herë nuk iki nga puna dhe obligimet, por kërkonte punë, niste punë dhe ngarkohej me obligime, por edhe hapte obligime për të tjerët.

Për të kontribuar në afirmimin dhe rritjen e Universitetit ai pranoi dhe kreu me shumë përgjegjesi dhe suksesshëm funksione të ndryshme me rëndësi shoqërore dhe qeverisëse si ato të prodekanit dhe të dekanit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Kryetarit të Shoqatës së Arsimtarëve Universitarë dhe të Punëtorëve të tjerë Shkencorë të Kosovës dhe atë të Prorektorit të Universitetit të Prishtinës. Në të gjitha këto detyra me përgjegjësi ai tërë energjinë e vet intelektuale e kombëtare e derdhi në mbrojtje të Universitetit, veçanërisht në periudhën më të

vështirë dhe më dramatike të jetës dhe të rritës së tij, siç ishte periudha e pas vitit 1990 e këndej, kur Serbia u vërsul me të gjitha mjetet dhe metodat për zhbërjen e tij dhe për zhbërjen e arsimit dhe kulturës shqiptare në përgjithësi, siç do ta vërtetojnë ngjarjet në vijim, sidomos dhuna, terrori dhe gjenocidi shtetëror serb i vitit 1998/1999 ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Me vemendje të veçantë përcillej puna dhe aktiviteti i stafit mësimdhënës dhe organeve udhëheqëse të Universitetit të Prishtinës. Kjo dhunë e egër serbokomuniste aq me tepër mori tipare gjenocidale pas vitit 1989, kur Serbia me me tërë forcën dhe në kundërshtim me të gjitha normat juridike vendore dhe ndërkombëtare, duke përdorur policinë dhe ushtrinë, e suprimoi dhunshëm autonominë e Kosovës (mars 1989).

Gjatë gjithë kësaj periudhe të vështirë për Kosovë, popullin e saj dhe Universitetin, Akademik Eshref Ademaj u gjend në ballë të formave të ndryshme të rezistencës për mbrojtjen e Universitetit, duke reaguuar pranë organizmave të ndryshëm në nivel vendi (ish Jugosllavisë), pranë shoqatave, institucioneve dhe mekanizmave të ndryshme ndërkombëtare, duke shkruar dhe botuar publikime të ndryshme në gazetatat prestigjioze të ish Jugosllavisë dhe Evropës, duke ju kundërvu proceseve të ndryshme antikombëtare të kohës të cilat i ndërmernte LKJ, siç ishte i ashtuquajtur i diferencimi ideopolitik dhe duke qëndruar afër studentëve, duke i inkurajuar ata që të mos bien pre e provokimeve dhe dhunës policore serbe.

Kontributi kombëtar i Akademik Eshref Ademaj arrin kulminacionin e vet pas vitit 1989, në kohën kur Serbia në mënyrë joligjore dhe të dhunshme suprimoi autonominë e Kosovës (mars 1989) dhe filloi të rrënojë çdo gjë që frymonte shqip, në veçanti sistemin arsimor shqiptar, duke u nisur nga niveli parafillor e gjerë në atë sipëror-universitar. Në kohën më të vështirë të mbijetesës së Universitetit të Prishtinës dhe të popullit shqiptar në përgjithësi, ai u gjend në ballë të Shoqatës së Arsimtarëve Universitar dhe të Punonjësve të tjerë Shkencorë të Kosovës dhe me vonë edhe në pozitën e Prorektorit të Universitetit, dhe u vu në ballë të protestave,

demonstratave dhe formave të tjera të rezistencës në mbrojtje të shkollës shqipe dhe të Universitetit të Prishtinës.

“Akademik Ademaj e kishte të qartë se Serbia komuniste ishte duke u përgatitur për një fushatë të egër ndaj shkollës shqipe në përgjithësi dhe Universitetit të Prishtinës në veçanti. Populli shqiptar në Kosovë dhe shkolla shqipe ishin duke përjetuar çaste të vështira, bile dramatike. Me metoda më të vrazhda Serbia po atakonte vlerat më të ndritshme të popullit shqiptar, të cilat i arriti me shumë mund.

Pas terrorit policor-ushtarak mbi rinin shqiptare të Kosovës, pushteti okupues serb-komunist, po përgatitej për një fushatë të tmerrshme të dhunës edhe mbi shkollën shqipe. Qëllimi ishte i qartë, shkatërrimi i të gjitha themeleve të shkollës shqipe, në të gjitha nivelet. Në shënjesër sidomos ishte Universiteti i Prishtinës.

Ky institucion tejet i rëndësishëm i arsimimit të të rinjëve tanë, sipas profesor Ademaj, që moti ishte bërë halë në sy për forcat shoviniste serbe, të cilat vazhdojnë ta quajnë atë “bastion, kështjell, vatër...” e nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar. Për ta mbrojtur universitetin nga kjo dhunë e cila po përgatitej nga forcat shovene serbe, profesor Ademaj me bashkëpunëtorët ndërmorri veprime konkrete.

Në vazhdën e këtyre veprimeve është edhe organizimi dhe mbajtja e Tubimit të Arsimitarëve të Universitetit të Prishtinës më datën 26 shkurt 1990<sup>1</sup>. “Shoqata e ka një obligim që për situatën e krijuar t’i shpreh vrejjet e veta për rrethanat e krijuara në këtë tubim, sepse deri tash ato nuk mundem t’i paraqesim para organeve shoqërore-politike dhe të tjera. Kohëve të fundit po udhëhiqet një fushatë e rëndë ndaj universitetit e cila i ka prekur dhe shqetësuar punonjësit e këtij institucioni më të lartë kërkimor, studentët dhe përgjithësisht banorët e Kosovës. Pakënaqësin tonë e shkaktuan vrasjet e mbi 30 qytetarëve shqiptar dhe plagosja e mbi 200 të tjerëve, pastaj rrahjet, maltretimet,

---

<sup>1</sup> Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 27.02.1990

burgosjet, plaçkitjet dhe keqpërdorimet e tjera të detyrës zyrtare nga ana e disa milicëve të aradhës së bashkuar. Gjithashtu edhe Ligji për Univeristetin i cili është aprovuar anipse diskutimi publik në Kosovë atë e ka hedhur posht”<sup>2</sup>.

Nga ky tubim të cilin e kryesoi Akademik Eshref Ademaj, dolën qëndrimet që shërbyen si udhërrëfim për veprimin politik në periudhën para zhbërjes përfundimtar të Jugosllavisë. Qëndrimet përfundimtare që dolën nga ky Tubimi i Mesimdhënësve Universitar dhe të Punëtorëve Shkencorë ishin:

- depolitizimi dhe deideologjizimi i Univeristetit,
- shpërndarja e të gjitha organizatave të LKJ-së në UP,
- të ndërpritet diferencimi ideopolitik,
- të kthehen në punë të gjithë të anatemuarit,
- Univeristetit t'i kthehet autonomia dhe të mbrohet nga sulmet e pabaza



---

<sup>2</sup> Gazeta “Rilindja”, 27.02.1990

“Në vitin 1990 u nxor vendimi për masat e dhunshme në Universitetin e Prishtinës nga Kuvendi i Republikës së Serbisë, ndërsa në qershor 1991 u futën masat e dhunshme në Universitet dhe në fakultete. Më 27 qershor të atij viti, Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë miratoi këtë vendim: "Për aplikimin e masave të përkohshme për mbrojtjen e të drejtave vetëqeverisëse dhe të pasurisë shoqërore ndaj Universitetit të Prishtinës dhe ndaj fakulteteve në përbërje të tij, Fakultetit Filologjik, Fakultetit Filozofik, Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit Elektroteknik, Fakultetit të Makinerisë, Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe të Arkitekturës, Fakultetit të Bujqësisë, Fakultetit të Arteve, Fakultetit të Kulturës Fizike dhe ndaj Fakultetit XehetarMetalurgjik të Mitrovicës." ("Sluzbeni glasnik SRSË, nr. 38, Beograd, 27.VI.1991)"<sup>3</sup>.

“Në fillim të vitit akademik 1991/1992 profesorët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës nuk e nënshkruan marrëveshjen me Bashkësinë e Shkollave të Larta dhe me Bashkësinë e Fakulteteve të Serbisë. Më 1 tetor 1991 Fondi Krahinor për Arsimin e Lartë në Kosovë ndërpreu financimin e mësimin shqip në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta. Studentët dhe arsimtarët shqiptarë u përjashtuan nga Universiteti i Prishtinës. Përjashtimi i arsimtarëve shqiptarë nga Universiteti i Prishtinës gjatë vitit 1991, në historinë e arsimit të lartë të Kosovës, do të mbetet si një akt jociwilizues, jonjerëzor dhe antishqiptar i pushtetit serb”<sup>4</sup>.

Përkundër përpjekjeve të pareshtura, të egra, jociwilizuese dhe joligjore të “shtetit juridik serb-komunist” të kohës, për zhbërjen e sistemit arsimor të shqiptarëve, në veçanti për zhbërjen e Universitetit të Prishtinës në mësim në gjuhën shqipe, Akademik Ademaj ishte i bindur në dështimin e plotë të qarqeve serbomadhe për realizimin e koncepteve të errëta dhe hegjemoniste serbe, ngase siq theksonte

---

<sup>3</sup> Botimi i veçantë, Universiteti i Prishtinës 1970-2005, Prishtinë, 2005, fq, 24

<sup>4</sup> Botimi i veçantë, Universiteti i Prishtinës 1970-2005, Prishtinë, 2005, fq, 24

profesori këto koncepte janë të gjykuara të dështojnë.

Akademik Ademaj në menyrë energjike, të vendosur, të argumentuar dhe publike ju kundërvu të gjitha këtyre përpjekjeve hegjemoniste dhe antidemokratike të politikës komuniste- serbe, mbi të gjitha fuqishëm ju kundërvu aplikimit të masave të dhunshme administrative të cilat shteti komunist-serb në mënyrë thellësisht joligjore i zbatojë në Universitetin e Prishtinës, nje akt ky i cili dëmtonte rëndë sistemin e arsimit të popullit shqiptar, jo vetem në Kosovë por edhe në viset e tjera të ish Jugosllavisë ku jetojnë shqiptarët.

Lidhur me aplikimin e masave të dhunshme administrative dhe represionin tjetër serb në Universitetin e Prishtinës, Akademik Eshref Ademaj në intervistën dhënë gazetës studentore "*Bota e Re*" nr. 17 të datës 3 gusht 1991 shprehej: "Qysh nga viti 1981 represioni ndaj Universitetit të Kosovës merr nuanca me të vrazhda që nuk njihen fare në botën e civilizuar dhe as figurojnë diku në aktet ndërkombëtare. Rreth shkeljes së autonomisë së Universitetit të Kosovës siç është vepruar sot me aplikimin e masave të dhunshme, që në gjithë botën, njihet si rast unik, vrazhdësia tejkalon gjithë kufijtë".

"Më duket se rrugëdalje tjetër nuk ka. Në qoftëse nuk i konvenon pushtetit serb të ekzistojë universiteti në gjuhën shqipe atëher duhet të përgatitemi edhe që nga fillimi i vitit akademik të organizojmë universitetin në gjuhën shqipe e lë urdhërojë atëher Serbia dhe të bëjë universitetin në gjuhën serbe në Kosovë. Por mos të harrojmë se 90% e popullatës së Kosovës është shqipëtar e 10 % janë pakica kombëtare ( serb, malazez etj). Mohimi i Universitetit në Gjuhën shqipe, siq e tha edhe vetë Papoviqi është rast eklatant dhe i vetëm në botë. Ne nuk do të lejojmë këtë, prandaj do të organizojmë forma të reja në universitet dhe e vetmja rrugë është mësimi paralel. Me gjithëse janë prishur marrëdhëniet në Universitetin e Kosovës në Prishtinë, sidomos me vendosjen e masave të dhunshme, unë mendojë se nuk ka kurrfarë baze të kemi më

universitetin e përbashkët, andaj le të mendojë qeveria e Serbisë, le të mendojë edhe federata, se ne nuk heqim dorë nga Univeristeti i Kosovës, as nga shkollat e mesme as nga programet mësimore. Ky është betimi i gjithë popullit, pranad j këthim prapa dhe dorëheqje nuk ka”.

“Serbia po përpiket të rrënojë çdo gjë shqiptare në truallin e Kosovës. Ajo pandeh se me dhunë mund ta mbajë një popull të tërë të okupuar. Mirpo me internacionalizimin e çështjes së Kosovës dhe të asaj shqiptare në përgjithësi u kompromitua politika “largëpamëse” millosheviqiane në Kosovë. Në vend se të përmisojnë gabimet fatale mbi institucionet arsimore e shkencore kosovare, pushteti okupues serb ashpëron gjendjen e tërësishme në to dhe përgjithësisht në Kosovë. Padyshim Serbinë dhe shovinistët serb i pengon rritja e deritashme e Univeristetit të Kosovës, të gjithë ato kadro profilesh të ndryshme, ekspert e punonjës shkencor, të cilët i vënë themelet e këtij institucioni dhe krijuan një bazë të forte për prespektivën e ndritshme të mbarë Kosovës”<sup>5</sup> “Autonomia e Universitetit të Prishtinës duhet mbrojtur me çdo kusht, sepse është kërkesë dhe nevojë e popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset tjera të jugosllavisë, që janë autoktone në viset ku jetojnë, ndaj edhe janë plotësisht legjitime e të patjetërsueshme të drejtat e tyre për arsim, shkencë e kulturë”<sup>6</sup>.

Akademik Eshref Ademaj në të gjitha intervistat, konferencat, tubimet publike dhe aktivitetet e tjera nuk hezitojë që veprimet dhe aktet e njëanshme dhe jologjore serbe mbi institucionet legjitime të Kosovës dhe Universitetit të Prishtinës t’i klasifikojë dhe emërtoj si veprimeve gjenocidale, përmes të cilave ajo synon që t’i përmbys sukseset dhe të arriturat shkencore tashmë të afirmuar të kuadrit shkencor shqiptar në botë. Gjithashtu ai i gjykojë ashpër dhe publikisht të gjithë ata të ashtuquajturit intelektual të cilët pushteti serb i angazhoi në procesin arsimor dhe të cilët u tjetërsuan dhe u shëndërran në emër të parave dhe


---

<sup>5</sup> Ademaj prof.dr.Eshref, Grushteti Serbian në shkollën shqipe, Revista Dielli, Prishtinë, 1991,fq.12

<sup>6</sup> Shefqet Rexhepi, Revista Tribuna, Prishtinë, 1991



të patriotizmit verbërues, në mercenar të paskrupllët, duke u rekrutuar dhe u vërsulur kundër çdo gjëje që është shqiptare. “Serbia deshi t’i tregojë shqiptarëve se kush është me të shpërblehet edhe në këtë mënyrë dhe kush e kundërshton mund të ndëshkohet kështu dhe në mënyra të tjera edhe më banale e më të shturura. Mirpo, meqenëse as kështu nuk arriti ti “mbush mend shqiptarët”, e ka vënë në shënjestër tash gjithë Universitetin e Kosovës dhe me një të rënë kërkon ta serbizoj atë dhe ta flakë në udhë gjuhën shqipe”<sup>7</sup>.



Duke qenë në krye të Shoqatës së Arsimitarëve Universitarë dhe e Punëtorëve të Tjerë Shkencor të Kosovës akademik Ademaj organizojë edhe forma të tjera të kundërshtimi ndaj politikave serbe, si tubime, protesta dhe demonstrata. Të gjithë ata që e kanë njohur për së afërmi dhe kanë bashkëpunuar me profesorin, e vlersojnë lartë kontributin e madh të tij dhe me të drejtë e kanë quajtur kryetari legjendar i këtij asociacioni. Me atdhedashurin e madhe që kishte, me entuziazmin, guximin dhe bindjen në fitoren përfundimtare, arriti me sukses të bashkërendojë të gjitha format e mundshme të rezistencës kombëtare në shërbim të çështjes madhore kombëtare gjatë viteve

<sup>7</sup> Shkëndija, Prishtinë, dhjetor 1990;

nëntëdhjeta.

Akademik prof.dr.Eshref Ademaj,veçanërisht në vitet 1989,1990,1991 e derisa ndërrojë jetë,padyshim ishte personaliteti, përkatësisht njëri nga kolosët më të mëdhenjë në mbrojtjen e UP-së, për mëvetësimin e tij dhe sigurimin e vazhdimsisë së misionit të tij madhor civilizues e kombëtar në kushte të jashtëzakonshme, në shtëpit-shkolla.

"Zguarsia e tij për ta ndalë kohën, e për ta shpenjë atë përpara në në edhe koha vetë zuri të trembej me 1990-1991. Nuk lejoi të ndalet koha por vetem e drejtoi Universitetin edhe pse të zhvendosur, në drejtim të duhur, që e nxe kohën; në drejtim që vazhdohet. Për të mos u ndalur mendja, shpirti e zemra e popullit, edhe pse rrebeshi i kohës, e njeriu rrebesh derdhej me tërë vrazhdësinë në Universitet, ai nuk u frikësua që për të luftojë në Prishtinë, në Beograd, në Tiranë e gjetiu që koha të ece dhe Universiteti bashkë me te".

Në mbrotje të autonomisë së Univeristetit të Prishtinës, kundër masave të dhunshme administrative në të gjitha institucionet shkencore e kulturore të Kosovës dhe të njohjes së Kosovës statusi i Republikës, studentet e Universitetit të Prishtinës gjatë muajit qershor 1990 (18, 25 dhe 27 qershor) organizuan tri tubime protestuese dhe greven studentore. Edhe në këto tubime protestuese u shtruan kërkesat për: largimin nga Kosova të formacioneve speciale ushtarake-policore serbe, t'i kthehet autonomia Univeristetit të Prishtinës, të hiqen masat e dhunshme në të gjitha institucionet shkencore e kulturore të Kosovës, të lirohen të gjithë të burgosurit politikë shqiptar që mbahen nëpër kampet e përqendrimit në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe vende të tjera.

Tubimi i dytë (25 qershor) ishte shumë masovik dhe dinjitoz, marshuta studentore paraqiti një simbolikë të fortë dhe një paralajmërim se nga Universiteti nuk do të hiqet dorë në asnjë mënyrë, Edhe pse nga policia serbe nuk u lejua daljen e studentëve dhe mësimdhënësve në rrugë, ata arriten të parakalojnë hapësirën në mes Filologjikut, rreth Bibliotekës Universitare deri

te Fakulteti juridik.

Në këtë tubim protestues të cilin e organizoi Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Kosovës, të pranishmëve ju drejtua edhe prof.dr.Eshref Ademaj, i cili theksoi se dhuna dhe terrori që po ushtrohet ndaj Universitetit dhe arsimit shqiptar tash e sa kohë, sivjet (1990-1991) arriti kulminacionin.



**UNIVERSITETI NË PRANGA**



Në këtë tubim të nënërkëmbien e shkolleve tona: Aspekt nga tubimi protestues para Fakultetit Filologjik

Me këtë po tentohet të shuhet arsimit kosovar dhe përgjithësisht ai shiptar në Jugosllavi, prandaj kemi ngritur dhe do ta ngrermë zërin që t'i jepet fund kësaj dhune dhe do ta mbrojmë universitetin tonë, pa marrë parasysh dhunën dhe presionin policor që po ushtrohet mbi ne.

Gjithashtu më datën 27 qershor 1991 përsëri u organizua një tjetër tubim protestues, tani në ambientet e Fakultetit Teknik të Universitetit të Prishtinës, me po të njejtin qëllim, pra të kundërshtimit të politikave shtypse të shtetit policor serb, ndaj popullit shqiptar në Kosovë dhe në mbrojtje të shkollës shqipe dhe të Universitetit të Kosovës. Masës së tubuar studentore dhe mësimdhënësve universitar ju drejtua prof.dr. Eshref Ademaj.

Se regjimi serbokomunist millosheviçian nuk do të tërhiqej nga vendimet e erreta dhe shoviniste për mbylljen definitive të shkollës shqipe në Kosovë dhe të Universitetit, vendime këto të cilat ishin në **kundërshtim** të plotë edhe me Kushtetutën e vetë shtetit jugosllav dhe me të gjitha Konventat ndërkombëtare, u vërtetua kur me 2 shtator 1991, në ditën kur duhej të fillonte mësimi për vitin e ri shkollor 1991/1992 për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës, policia dhe ushtria serbe vendoset para ndërtesave shkollore dhe nuk lejoi hyrjen e nxënësve dhe mësimdhënësve shqiptarë në këto godina shkollore, pra nuk lejoi fillimin e mësimi për nxënësit shqiptarë. Kjo ndodhi edhe me studentët dhe pedagogët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës në fillim të vitit akademik 1991/1992. Para dyerve të Fakulteteve të Universitetit të Prishtinës ishin vendosur forca të shumta policore serbe dhe mjete të blinduara.

Në mbrojtje të shkollës shqipe dhe të Universitetit të Prishtinës, Lidhja e Arsimitarëve Shqiptar "Naim Frashëri", Sindikata e Pavarur e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës dhe Shoqata e Pavarur e Arsimitarëve Universitarë dhe Punëtorëve Shkencorë të Kosovës, të cilës i printe

Akademik Eshref Ademaj, më datën 10 shtator 1991 organizuan protestë gjithëpopullore në Prishtinë me qëllim të kundërshtimi të politikave kriminale serbe dhe informimit sa më të plote dhe të drejtë të opinionit të vendit dhe atij ndërkombëtar për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej tashmë arsimit shqip në Kosovë.

"Gjatë protestës policia përdori dhunë. Në shënjestër ishin intelektualët më të njohur. U rrah një akademik, shumë profesorë të Universitetit, veprimtarë të partive politike etj. Për dallim nga herët e tjera policisë serbe iu kishte bashkangjitur edhe popullata serbe, e cila kishte provokuar protestuesit me sirena të veturave, të autobuseve, kishte përdorur fjalorin më banal ndaj shqiptarëve, etj. Policia serbe përveç rrahjes dhe maltretim të protestuesve në këtë rrëmujë arriti të arrestojë veprimtarë të arsimit, studentë e nxënës. Ishin të arrestuar për pak kohë prof.dr. Fehmi Agani, prof. dr. Eshref Ademaj, mr. Fatmir Sejdiu, Hazir Rekej. Gjatë këtyre ditëve ishin ftuar në biseda informative Zejnullah Jakupi, ish kryeinspektori i arsimit i Kosovës, Nazmi Caka këshilltar në Pleqësine e Arsimit të Kosovës etj."

Protesta ishte shumë masive, protestuesit me prezencën e tyre treguan edhe një herë gadishmërin e tyre për ta mbrojtur interesin nacional të tyre dhe shkollën shqipe. Qëndrimi dinjitoz por njëkosisht edhe i guximshëm dhe insistues i protestuesëve në mbrojtje e të drejtave kombëtare përfundimish e vërtetoi faktin se shqiptarët e Kosovës ishin të pandalshëm në realizimin e kërkesave të tyre të drejta, shekullore për liri dhe pavarësi.

Në këto protesta studentët dhe protestuesit mbanin këto pankarta: "Rroftë Universiteti i Kosovës", "Duam bukë", "Duam shkollë", "Pa liri s'ka demokraci", "Të rrënohet muri i Berlinit mes shqiptarëve", "Rroftë Bashkimi Kombëtar" etj. Edhe, pas kesaj proteste Serbia nuk u zbraps nga veprimet dhe masat e saja represive dhe kriminale kundër arsimit dhe shkollës shqipe dhe nuk lejoi fillimin e mësimin për nxënësit shqiptarë në nivelin parauniversitar, as me datën 16 shtator 1991, sipas kërkesës së LASH-it.

Me 24 shtator 1991 në Prishtinë, para Fakultetit Filologjik u organizua një protestë tjetër nga arsimtarët dhe studentët e Universitetit të Prishtinës, për t'a mbrojtur arsimin dhe gjuhën shqipe. Në ballë të protestuesve ishte prof.dr.Eshref Ademaj, Kryetar i Shoqatës së Arsimtarëve të Universitetit. Në këtë protestë profesor Eshref Ademaj lexoi tekstin ku ishin të parashtruara kërkesat e protestuesve, por nuk arriti ta perfundojë leximin e tekstit të përgatitur dhe u detyrua ta ndërpres diskutimin sepse policia serbe ndërhyri dhunshëm (duke përdorur shufrat e gomes dhe mjete të tjera të forte të dhunës) dhe shpërndau protestuesit.



## Dhuna s'njeh argumente

Fjala e Prof. Dr. Eshref Ademajt në Tubimin  
protestues të datës 23 shtator 1991

**“Protestojmë në mënyrë të ashpër dhe të vendosur, kundër politikës shoviniste antishqiptare, të Jugosllavisë dhe të Serbisë, politikës së aparteidit, të segregacionit, të gjenocidit dhe të terrorit kundër shqiptarëve, kundër mbylljes së Universitetit të Kosovës dhe shkollave për nxënësit dhe studentët shqiptar”**

**Eshref Ademaj (1991)**

Politika antishqiptare, diskriminimit, gjenocidit dhe e segregacionit ndaj shqiptareve në Kosovë vazhdon me tërë vrazhdesine, duke vënë masa të dhunshme jokushtetuese, joligjore e jociivilizuese, ne institucionet e kultures dhe të shkences, si dhe ne shkollat e të gjitha niveleve, duke larguar me dhunë nga procesi mesimor e puna profesoret e Univeristetit, ekspertet e punonjesit shkencore e profesionale, personelin mesimor të shkollave dhe punetore të tjere, duke bere të pamundur regjistrimin e stu-denteve e të nxenesve shqiptare, duke mbyllur praktikisht shkollimin ne gjuhen shqipe. Në Universitet dhe në shkolla, duke shkelur të drejtat elementare të njeriut dhe kolektive të shqiptareve, si dhe të drejtat e tyre nacionale.

Serbia ne fakt ka bere grushtet ne Kosove, politika shoviniste e represionit dhe aparteidit e organeve serbe kinder shqiptareve ne Kosove ka marre permasa shqetesuese, pa precedence ne historine e re të botes, arsimi, kultura dhe shkenca në Kosove per shqiptaret u suprimuan, mesimi ne gjuhen shqipe per nxenesit shqiptare praktikisht pa mbyllet, se ne Universitet e Kosove, ne institucionet shkencore e të kultures dhe ne shkollat e të gjitha niveleve eshte aplikuar administrimi i dhunshem dhe se nga ato me dhune jane perjashtuar me qindra profesore të Universitetit, eksperte e punonjes shkencore, personel tjetër mesimor i shkolles, mjeke e punetore to kombit shqiptar, se ata jane vënë mes kudhtës dhe qekanit, maltreohen fizikisht dhe psikikisht nga pushteti okupues serb, se Jugosllavia nuk respekton Kushtetuten dhe ligjet si dhe as dokumentet finale të KSBE-se e të Kombeve to Bashkuara mbi të

drejtat njerezore e nacionale, kur eshte fiala per shqiptaret duke mohuar edhe to drejtat elementare per arsim, shkence e kulture, me mbylljen e shkollave dhe të Universitetit dhe duke u nisur nga fakti se asnje popull nuk heqe dore nga nje begati siç eshte shkolla, shkenca dhe Universiteti, protestojme në menyren me të ashper dhe të vendosur kunder politikës shoviniste antishqiptare të Jugosllavise dhe të Serbise, politikës së aparteidit, të segregacionit, te gjenocidit dhe te terrorit kunder shqiptareve, kunder mbylljes se Universitetit te Kosoves dhe shkollave per nxenesit dhe studentet shqiptare, si dhe te inistitucioneve te tjera kulturore e shkencore, largimit me dhune te profesoreve te Universitetit, te eksperteve e te punonjesve shkencore, te personelit mesimor te shkollave, si dhe te punetoreve te tjere nga procesi mesimor, kunder heshtjes se orgarzeve federative të te gjitha niveleve ndaj politikës hegjemoniste serbomadhe qe zbatohet ne Kosove ndaj shqiptareve, kunder indiferences dhe heshtjes se opinionit demokratik te vendit, të atij evropian e botëror, per politiken shtypese ndaj shqiptareve, te Universitetit dhe shkollës shqipe, kunder indiferences dhe heshtjes se organizmave ndërkombëtare edhe kur Jugosllavia nuk respekton dokumentet e aktet e tyre, nenshkruese e te cilave eshte ajo.

*(Në këtë moment policia serbe urdhëroi në mënyrë kategorike, të dhunshme të nderpritet menjëherë tubimi, policët u drejtuan me shufra gome e të armatosur gjer në dhëmbë. Për të mos ardhur gjer te më e keqja, udhëheqësit e tubimit iu drejtuan të pranishmeve (le te shpërndahen).*

**Gazeta Bujku, datë 24 shtator 1991**



Kërkesat e protestuesve shqiptarë, të parashtruara në protestat e përmendura nuk u përfillen nga shtetit serb dhe gjendja mbeti e pandryshuar, andaj më 2, 3 dhe 4 tetor 1991, përsëri u organizuan protesta gjithëpopullore në mbrojtje të shkollës shqipe dhe të universitetit. Tani keto protesta u organizuan para ndërtesave të shkollave, në të gjitha vendbanimet e mëdha të Kosovës (qytete dhe fshatra). Pjesëmarrja e protestuesve ishte masive, ndërhyrjet e policisë ndaj protestuesve ishin brutale, pati shumë të rrahur dhe të burgosur.



Shtetit serb i personifikuar përmes policisë dhe ushtrisë serbe kishte pushtuar shkollat shqipe dhe Universitetin e Prishtinës. Për ta përballuar këtë situatë të vështirë ishte formuar një Këshillë Koordinues i udhëhequr nga prof.dr. Fehmi Agani. Anëtar të këtij këshilli ishin edhe: prof.dr. Eshref Ademaj, prof.dr.Pajazit Nushi, prof.Halim Hyseni, Burhan Kavaja dhe Munish Hyseni. Ky këshillë koordinues miratoi strategjinë për fillimin e mësimin përkatësisht vitin shkollor 1991/1992 në shtepit-shkolla. "Në këtë mënyrë fillojë rimëkëmbja e arsimit shqip.

Më 6 janar 1992 (sipas këtij modeli) startoi nga puna shkolla e parë shqipe, e pavarur nga sistemi arsimor serb. Ishte ky gjimnazi "Xhevdet Dada" i cili mësimet i filloi falë angazhimit të drejtoreshes zonjës Zymryte Limani, në shtëpinë e Zijadin Gashit. Në muajin mars, po me këtë skenar fillojë viti i ri akademik në Universitetin e Prishtinës.

Akademik prof. dr. Eshref Ademaj ishte ideatori dhe organizatori kryesor i vazhdimit të punës të Universitetit të Prishtinës në mënyrë legale dhe institucionale nëpër objekte private, pas aplikimit të masave të dhunshme administrative të Serbisë në këtë universitet dhe i të gjitha formave të rezistencës aktive të studentëve, mësimdhënësve dhe popullit shqiptar në Kosovë në mbrojtje të Universitetit, duke përfshirë edhe protestat dhe demonstratat që nga viti 1991 e në vazhdim (1994 kur profesori i nderuar ndërroi jetë).

Në bazë të projektit të Akademik prof.dr.Eshref Ademaj dhe të bashkëpunëtorëve të tij në vitin akademik 1991/1992 filloi periudha e rimëkëmbjes dhe e mbijetesës së Universitetit të Prishtinës (studimet në gjuhën shqipe) edhe pse në kushte të jashtëzakonshme.

Nga qershori i vitit 1991, kur masat e dhunshme u futën në të gjitha njesitë akademike të Universitetit, prof. Eshref Ademaj nuk ishte më vetëm kryetar i Shoqatës së Arsimitarëve të Universitetit të Prishtinës, ai u bë pikë referimi për të gjithë njerëzit në Universitet. Në kohën kur organet e zgjedhura në mënyrë legjitime ishin jashtë funksionit, prof. Ademaj ishte njeriu që këshillonte, udhëzonte, drejtonte dhe i merrte përgjegjësitë për të gjitha veprimet që merreshin si përgjigje ndaj dhunës së organizuar shtetërore serbe.

Vetëm disa ditë pas futjes së masave të dhunshme profesor dr. Eshref Ademaj u përjashtua nga puna dhe iu ndalua hyrja në Universitet. Banesa e tij u bë vend ku debatohej për zgjidhjet e mundshme dhe merreshin vendime, pikë ku drejtoheshin të gjithë që kishin për qëllim të kontribuonin për mbijetesën e shkollës shqipe dhe pavarësimin e saj nga sistemi arsimor serb-komunist.

"Në qershor të vitit 1991 organizoi mbledhjen e Kuvendit të Universitetit të Prishtinës në një sallë të Fakultetit Filologjik dhe aty merret vendimi për shpalljen e konkursit për regjistrimin e studentëve të rinjë në Universitetin e Prishtinës për vitin akademik 1991/1992, konkurs ky që u realizua po në atë afat në kushte tepër të rënda dhe ky ishte momenti kyq që e shpetoi Universitetin e Prishtinës nga shthurja e tërësishme e tij.

Pas largimit të mësimdhënësve dhe studentëve shqiptarë me dhunë nga Universiteti i tyre, Shoqata e Arsimitarëve të Pavarur Universitarë dhe profesor Eshrefi-kryetar i saj bëhen strumbullar i gjithë aktiviteteve për rilindjen e Universitetit. Në këtë punë ndihmon Unioni i Studenteve dhe Sindikata universitare.

Më 26 nëntor të vitit 1991 u mbajt mbledhja e Kuvendit të Universitetit të Prishtinës, ku u vendos vazhdimi i mësimit (studimeve) në gjuhën shqipe jashtë lokaleve legale të cilat ishin të uzurpuara nga administrata e dhunshme dhe policia serbe. Në këtë mbledhje u zgjodhen edhe strukturat e reja drejtuese të Universitetit të Prishtinës. Prof. Dr. Ejup Statovci u zgjodh rektor, ndërsa Prof. Dr. Eshref Ademaj u zgjodh prorektor. Në këtë kuader u bë edhe konstituimi i organeve drejtuese të fakulteteve dhe të shkollave të larta të këtij universiteti.

Me 5 dhjetor 1991, Kolegjiumi i Dekaneve mbajti mbledhjen e parë ku u vendos për hapat që duhet marrë për organizimin e punës mësimor-shkencore në kushte të jashtëzakonshme, në lokale private. U vendos gjithashtu që kjo veprimtari të jetë publike dhe legale e bazuar në dispozitat ekzistuese ligjore dhe në vendimet e institucioneve të Kosovës. Në mbledhjen e Kuvendit të Universitetit me 10 dhjetor 1991,

rektori Prof. Dr. Ejup Statovci paraqiti programin e punës dhe parashtroi vizionin e tij për organizimin e punës në këtë institucion.

Në të gjitha këto aktivitete të organeve të universitetit, kontributi i Akademik Eshref Ademajt ishte i jashtëzakonshëm. Me rifillimin e punës së Universitetit në objekte private, nën udhëheqjen e Prof. Ademajt u mbrojt edhe një doktoraturë nga Teoria e Blink Dizajneve, duke simbolizuar vendosmërinë për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit akademik.

Nga viti akademik 1991/1992 e gjerë në vitin akademik 1998/1999, ndonëse në rrethana të jashtëzakonshme, në Universitetin e Prishtinës diplomuan 8785 studentë. Veprimtaria mësimore-shkencore dhe artistike në Universitetin e Prishtinës, në kushte të jashtëzakonshme vazhdoi deri më datën 21 mars 1999, kur u nderpre përkohësisht për shkak të luftës e cila ishte përshkallëzuar në Kosovë. Në këtë luftë (1998-1999) nga forcat kriminele serbe u vrane 322 studentë dhe 8 mësimdhënës të universitetit.

Akademik prof.dr.Eshref Ademaj paralelisht me punën e vazhdueshme, të gjithëanshme dhe intenzive në universitet, ka kontribuar edhe në aktivitetet e tjera të cilat i shërbenin çështjes kombëtare, duke përfshirë edhe Aksionin e Pajtimin të Gjaqeve në Kosovë, publikimet e shumta në revistat publicistike jashtë Kosovës, për informimin e opinionit relevant ndërkombëtar për gjendjen e vështirë të popullit shqiptar në Kosovë.



Akademik Ademaj, gjatë aksionit të pajtimimit të gjaqeve, 1991

I vetëdijshëm se për mbrotjen e shkollës shqipe, mbrojtjen e Universitetit të Prishtinës dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes të shqiptarëve të Kosovës, përveç organizimit të të gjithë faktorëve relevant në rrafshin kombëtar (intelektualëve, mësime dhënëseve, studentëve, artistëve, klasës punëtore dhe popullit shqiptar në përgjithësi), për t'i rezistuar dhunës dhe terrorit serbokomunist, duhej fituar edhe mbështetja e faktorit ndërkombëtar, sepse pa këtë mbështetje rruga jonë drejtë realizimit të aspiratave shekullore, për liri dhe barazi, për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, do të ishte shumë, shumë, më e zorshme, ju qas edhe një pune shumë të rëndësishme, sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar për dhunën dhe gjenocidin serb mbi popullin shqiptarë të Kosovës.

Në bashkëpunim me viktimologun kroat me renome botërore prof. Z. Sheparoviçin redaktoi librin "Kosova-Viktimë". Në përgatitjen e këtij libri kuptimplotë dhe mjaft argumentues dhe faktografik, me të cilin opinioni ndërkombëtar u njoh me dhunën dhe gjenocidin serb mbi popullin shqiptar të Kosovës, nga viti 1875 e këndej, ndihmuan me shkrimet e tyre shumë punetorë shkencorë dhe veprimtarë të Kosovës si: Skender Rizaj, Limon Rushiti, Hakif Bajrami, Fehmi Rexhepi, Jusuf Bajraktari, Selatin

Novosella, Eshref Ademaj, Muhamet Piraku, Pajazit Nushi, Zejnel Kelmendi, Zenun Celaj, Adem Demaçi, Ramiz Abdyli, Ymer Jaka, Ibrahim Osmani, Zekë Gecaj, Goran Hershak, Masar Stavileci, Remzi Bakalli dhe Rexhep Ismajli. Libri në fjalë, vërtet ishte nga punimet shkencore më të kompletuara i kësaj natyre, deri në atë kohë. Për fat të keq libri për shkak të kushteve nuk u botua edhe në gjuhën shqipe, por u botua vetëm në gjuhën kroate.

## UNIVERZITET KOSOVA U PRIŠTINI - ŽRTVA NASILJA

Eshref Ademaj\*

### 1. UVOD

Univerzitet Kosova u Prištini osnovan je 1970. god. kao izraz potrebe da albanski narod na Kosovu, nakon vjekovnih represalija što ih je trpio od osvajača, realizira svoje pravo na jezik, kulturu i znanost. Akt o osnutku rezultat je općenarodnog zahtjeva na Kosovu. Međutim, Srbija je stalno nastojala, i još uvijek nastoji uništiti tu nacionalnu tvrdavu, nazvavši je "TVRDAVOM NACIONALIZMA", kao što su to nažalost učinili i najodgovorniji rukovodioci Jugoslavije. Kakvim sve još pogrdnim imenima nije nazvan naš Univerzitet! Povijest će pokazati da nisu bili u pravu.

Cilj je ovoga rada da ukratko prikaže represiju na Univerzitetu u Prištini što je provodi tzv. pravna država Srbija pa i pravna država Jugoslavija. Vrlo je teško u ovoj situaciji otvoriti dosjee i dobiti sve arhivske materijale, jer se oni nalaze pod okupacijom. Stoga smo prisiljeni poslužiti se onim izvornim dokumentima koji su nam pri ruci, izvorima iz novina te memorijom (i ja sam bio student u prvoj generaciji na Filozofskom fakultetu - ogranaku Filozofskog Fakulteta u Beogradu). Ovaj tekst podijeljen je u nekoliko točaka uglavnom kronološki raspoređenih, s uobičajenim citiranjem dokumenata. Najvažnije činjenice pojedinih dokumenata navest ćemo ovdje, druge detalje čitatelj će naći u literaturi što je navodimo na kraju članka.

### 2. IDEJNOPOLITIČKA DIFERENCIJACIJA KAO METODA REPRESIJE

Jedna je od metoda kojom su se služili KPJ, SK Srbije i SK Kosova za uništenje Univerziteta na Kosovu tzv. idejno-politička diferencijacija. To je nastavak metode uništavanja albanskog naroda na Kosovu što su ga planirali Čubrilović i Ranković: proglasiti intelektualce i znanstvene radnike nepodobnim za rad, te ih istjerivati iz zemlje, zatvarati, ili ubijati jer navodno siju nacionalizam, šovinizam, separatizam, secesionizam, terorizam, čine genocid itd. (Zadnjih je godina diferencijacija postala političkim terminom u uporabi i u drugih naroda u Jugoslaviji.) Ovdje ću navesti samo neke kriterije što su ih donijeli SKJ, SKS i SK Kosova, na temelju kojih je stradalo 30 ljudi:

- Ukloniti s vodećih mjesta iz nastave i znanstvenog rada sve ljude "koji su došli u sukob sa politikom SKJ..., elemente koji su se u javnom i političkom životu eksponirali a i dalje se eksponiraju na birokratskim i etatičkim, tehno-kratskim i rankovičevskim pozicijama...".<sup>1</sup> Dakako stradali su i ljudi koji nisu bili članovi SKJ, znanstveni radnici i sveučilišni profesori

\*Prof. dr. Eshref Ademaj, predsjednik Nezavisnog udruženja univerzitetskih nastavnika i drugih naučnih radnika Kosova, redoviti profesor na PMF-u u Prištini.

Është për t'u theksuar se Akademik Eshref Ademaj ishte pjesë e delegacionit tre anëtarësh të profesorëve universitar e të punëtorëve shkencor të shqiptarëve të Kosovës (së bashku me Prof. Dr. Gazmend Zajmi, Prof. Dr. Ejup Statovci) të cilët u pritën në Pallatin e ish Federates Jugosllave në Beograd nga Kryetari i atëhershëm i RSFJ-së, Stipe Mesiq (korrik 1991). Delegacioni i kishte shprehur presidentit Mesiq, pezmin e popullit shqiptar për anashkalimin e shqiptarëve nga bisedat ku vendoset fati i tyre dhe mosvënja në rend dite të çeshtjes shqiptare, të cilën edhe bota pa e trajton. Rrënimi i autonomisë së universitetit dhe mësimin në gjuhën shqipe, heshtja për shkeljen e vrazhdë të të drejtave nacionale dhe të drejtave të njeriut, politika konfliktoze, torturat dhe fushata e tërbuar antishqiptare, rrënimi i dhunshëm (kujtojmë suprimimin e autonomisë së Kosovës me metoda represive policore-ushtarake, mars 1989) i subjektivitetit të barabartë të popullit shqiptarë në Jugosllavi etj. ishin tema të diskutuara me z. Mesiq.

Gjithashtu duhet theksuar se në vitin 1991 Akademik Eshref Ademaj kishte kryesor delegacionin e SHPAUPSH të Kosovës në vizitën zyrtare në Tiranë (pjesë e delegacionit ishin edhe Prof. Dr. Remzi Bakalli, Prof. Dr. Ejup Statovci dhe Prof. Dr. Binak Kastrati). Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëpunimi ndëruniversitar mes Prishtinës dhe Tiranës.

Akademik Eshref Ademaj kontribuoi në të mirë të çeshtjes kombëtare e shqiptare edhe si anëtar i KMDLNJ-së, me seli në Prishtinë. Gjithënjë ishte i gatshëm që delegacioneve të ndryshme ndërkombëtare të ju ofrojë të dhëna dhe dëshmi të dokumentuara, me të cilat dëshmohej dhuna, terrori dhe gjenocidi i shtetit okupues serb ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

*Skender Susuri*

VIZITA E DELEGACIONIT TE FEDERATES SE HELSINKIT NE KOSOVE

41. Mas uvg...  
W

# GJENDJE E VËSHTIRË NË SHËNDETËSI

● *Delegacioni i pritë nga zonja Kristin Ion Kol pardje vizitot klinikat e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, ku u njohua për rastet e shumta të debimit nga puna të mjekëve dhe të infermierëve shqiptarë, bisedoi në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut në Prishtinë me përfaqësues të enteve dhe të sindikatave të shëndetësisë, ndërsa dje vizitot Gllgovcih, Malishevën dhe Gjakovën*



Anëtarët e delegacionit të Federatës së Helsinkit gjatë bisedave në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë



Dr. Eshref Ademaj: «Dobio sam otkaz i zabranu pristupa na fakultet jer sam, navodno, remetio red- (Snimio: F.)

# Kad politika »zabran matematik

SUSRET S  
dr. **ESHREFOM  
ADEMAJEM,**  
»ISTJERANIM«  
PROFESOROM  
UNIVERZITETA  
U PRIŠTINI

Dobio sam otkaz zbog protivljenja uvođenju vremenih mjera na Univerzitetu, ostao sam posla, bez socijalnog osiguranja, zabranj mi je bavljenje znanošću, uskratili su mi pristup na fakultet, a zabranjen je čak i matematički časopis koji sam uređivao

— Vi ste, rekao bih, bivši profesor? Ili profesor bivšega fakulteta? — Dopustite da to kažem dno bi bilo i to da se prima



BISEDË ME PROF. DR. ESHREF ADEMAJ, KRYETAR I SHOQATËS SË PAVARUR TË ARSIMTARËVE UNIVERSITARË DHE PUNONJËSVE SHKENCORË TË KOSOVËS

## SERBIA PO PENGON FILLIMIN E VITIT TË RI AKADEMIK

● Nëse nuk plotësohen kërkesat tona të shtrura në tubimin e qetë protestues, që u pengua të r policia serbe, pra nëse nuk kthehen në punë punëtorët e larguar, nëse nuk ndalet dhuna ndaj studentëve dhe ndaj Universitetit në përgjithësi nuk ka as kushte minimale për fillimin e vitit të ri akademik të Kosovës e përgjegjësinë për këtë e mban Serbia

Në prag të vitit të ri akademik, më parë ka qenë si praktikë që të bisedohej me dikë nga njerëzit e parë të Universitetit. Zakonisht, biseda zhvillohej për parapergatitjet për pranimin e burcoshëve, pranimin e kuadrove të reja, hapjen e ndonjë drejtimi të ri, për aplikimin e ndonjë metode të re në punën pedagogjike dhe shkencore, për përgatitjet higjienoteknike të fakulteteve dhe të shkollave të larta, për vendosjen e studentëve në konvikte etj. Sivjet, siç dihet, gjendja në Universitetin e Kosovës është krejt ndryshe pas aplikimit të masave të dhunshme serbe dhe marrjes së plotë të autonomisë së Universitetit. Prandaj, edhe pyetja qëndrore që fatkeqësisht shtrohet në këtë moment është a ekzistojnë kushtet minimale që të fillojë fare sivjeti i ri akademik në këtë Universitet. Për këtë dhe gjendjen e përgjithshme në këtë moment në UK biseduam me prof. dr. Eshref Ademaj, kryetar i Shoqatës së Pavarur të Arsimtarëve Universitarë dhe i Punonjësve Shkencorë të Kosovës.

**Universiteti i Kosovës s'mund të funksionojë pa shqiptarët**

● **Zoti profesor, viti i ri akademik në Universitetin e Kosovës duhet të fillojë me 1 tetor. Rrethanat janë mjaft të rënda, prandaj a mendoni se ka kushte të fillimit?**

— Jo. Sepse deri sot Qeveria e Serbisë nuk ka bërë asnjë hap për përbushjen e kërkesave tona, d.m.th. kërkesave të Shoqatës së Pavarur të Arsimtarëve Universitarë e të Punonjësve Shkencorë të Kosovës dhe Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Kosovës. Nëse ato kërkesa nuk përbushen,

Universiteti serb. Deklaratat e të ashtuquajturit për ne «rektor», Radivoje Papoviçiqi, në të cilat nuk e pranon fare Universitetin në gjuhën shqipe janë metoda të bozhuristëve, çetnikëve sheshelist. Vetë fakti se Papoviçiqi propozon dhe vendos që Shesheli të bëhet arsimtar i UK si dhe fakti tjetër se edhe vetë Shesheli në deklaratat e veta publike (që i kam përcjellë në televizor) se «do të konkurrojmë» është provokim dhe tentim që në Universitetin tonë të zbatohet programi i tyre i njohur dhe i pakundërshtuar nga partitë tjera politike serbe. Është e qartë se ky program i tyre parashihet zhdukjen e plotë të shqiptarëve në Jugosllavi.

Lidhur me këtë qëndrim i Shoqatës është se Universiteti vetëm në gjuhën serbe nuk mund të ekzistojë, meqë këtë Universitet nuk e kanë formuluar serbët, por është themeluar, ka ekzistuar dhe do të ekzistojë si Universitet i Kosovës në Prishtinë, kur dihet se ai u dedikohet popullsisë shqiptare që përbën 90 për qind të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës, prandaj, mësimi vetëm në gjuhën serbe nuk ka mundësi të zhvillohet në këto troje.

**Do të angazhohemi për mbrojtjen e Universitetit**

● **Çka keni bërë Ju si Shoqatë dhe arsimtarë shqiptarë për fillimin e vitit të ri shkollor?**

— Shoqata e Pavarur e Arsimtarëve, Unioni i Pavarur i Studentëve dhe Sindikata e Pavarur Universitare vazhdimisht kanë vepruar në qenien e Universitetit. Në pamundësi që të paraqiteni në organet zyrtare universitare (siç janë BUJ, BUS dhe në qarqet tjera universitare) aktivitetin tonë e kanë shtrembëruar dhe e kanë keqpërdorë ish-rektori i Universitetit, Skënder Karahoda, ish-kryetari i KU të LKJ, R. Papoviçiq, ish prorektori, Misha Doshliqi, e fatkeqësisht aty ka kontribuar edhe kryetari i Kuvendit të Universitetit.

Me iniciativën e anëtarëve të Kuvendit, duke respektuar ligjin e Kosovës në fuqi dhe statutin në fuqi të UK, me vështirësi të mëdha u mbajt mbledhja e Këshillit Mësimor-Shkencor dhe e Kuvendit



Prof. dr. Eshref Ademaj

pse obligim i këtij asociacioni zbatohet konventat ndërkombitales së autonomisë së çdo unireguar edhe në CRE (Konferencë të Evropës) me seli në C asociacione i kemi njohuar por asnjë përgjegjësi e kemi informuar në një komision të tar edhe rektori i Universitetit S. Unkoviçiq!

Akademia Botërore e Përkrahjes së Nju-Jork, për informuar. Bile në një tubim të (dega për Evropë), ku i qësuesit e universitetëve të edhe ata të Kosovës të përha Doshliqi, Radivoje Kul Hafëz e ku ishin edhe për tës sonë (Eshref Ademaj dhe Dervish Rozhaja dhe Zey ne parashtuam argumente autonomisë së Universitetit përfaqësuesve të Austrisë bindur se ishte shkelur UK, përfaqësuesit e unillavisë në krye me Sadik BUJ heshtën.

Propozimi ynë që të on ndërgjegjshëm dhe ndtojë çështjen e shkeljes se edhe pse u pranua deri

● **Kjo që u tha nënkujtim më i madh i asociacionit për t'u ditur e vërteta i Universitetit të Kosovës.**

Deri tash të vërtet UK në botë e kanë shp sonë, Unionit të Stud Universitare edhe përf



